



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Sesioni pranveror

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport

Mbledhja nr.10

Prishtinë, më 08.04.2015, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ARSIM, SHKENCË, TEKNOLOGJI,
KULTURË, RINI DHE SPORT**

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, kryetar, Bekim Haxhiu, Ismajl Kurteshi, Salih Morina, Shpejtim Bulliqi, Shukrije Bytyqi, Teuta Haxhiu dhe Mufera Sinik.

Mungoi: Jelena Bontiç.

Pjesëmarrës të tjerë: Blendina Krasniqi-UNDP (praktikante), Qendrim Imeri-Gazeta Infodirek, Adelina Sopi-KKTK, Adelinë Sahiti-Kosova Press, Ukë Gashi-ZPRK, Isuf Koci-KKTK, Majlinda Doda-Rtk Radio, Kaltrina Rexhepi-BIRN, Isa Vatovci-Kosova Sot, Shaban Maxhurraj-Koha Ditore, Jetmir Bakija KDI, Ukë Gashi- Zyra e Presidentes, Driton Selmanaj -KDI

Stafi Mbështetës i Komisionit: Lule Ymeri dhe Shaip Goxhuli.

Mbledhjen e kryesoi Nait Hasani, kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

1. Miratimi i rendit të dits;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 01.04.2015;
3. Shqyrtimi i listës së kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore;
4. Shqyrtimi në Parim i Projektligjit për Provimin e Maturës Shtetërore;
5. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 01.04.2015

Procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 01.04.2015, u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i listës së kandidatëve për anëtarë të Këshillimit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore

Nait Hasani, kryetar i Komisionit, tha se në bazë të Ligjit për Trashëgimin Kulturore, Kuvendi duhet të bëjë emërimin e anëtarëve të Këshillit të Kosovës për Trashëgimin Kulturore. Ai shtoi se në listën e propozuar për anëtarë të Këshillit janë nëntëmbëdhjetë (19) kandidatët së bashku me dokumentacionin përkatës. Komisioni duhet të përzgjedh shtatë (7) kandidatë dhe ti procedoj për emërim në Kuvend.

Bekim Haxhiu, tha se në listën e kandidatëve të propozuar mungojnë të dhënat se cilit nacionalitet kush i përket, dhe propozoi që votimi të shtyhet për arsye se forma e praktikuar nuk është në pajtueshmëri me Ligjin për Trashëgimin Kulturore, dhe se me ligjet në fuqi Ministria e rregullon funksionimin e departamentit të Trashëgimisë Kulturore, por nuk precizohet që Ministria e ka përgjegjësi që të propozoj kandidatët për Këshillin, ai propozoi që komplet procedura të shkoj përmes Kuvendit përndryshe ky është një lloj konflikt interesi.

Teuta Haxhiu, tha se edhe në mandatin e kaluar kemi pasur probleme me funksionimin e Këshillit, mënyra e zgjedhjes së anëtarëve ka qenë e jashtë ligjshme, ndërsa Ligji në fuqi, nuk e përcakton qartë mënyrën e zgjedhjes së anëtarëve të Këshillit. Na mbetet që ne si anëtarë të këtij Komisioni të vendosim për mënyrën e zgjedhjes së anëtarëve të Këshillit, duke pasur parasysh se çdo vit Kuvendi ndan buxhet për këtë Këshill dhe shpenzimet janë të mëdha.

Ismajl Kurteshi, tha se nëse ka dilema rreth kësaj çështjeje është mirë që ta konsultojmë zyrën ligjore dhe të marrim udhëzime që janë në përputhje me ligjin dhe pastaj të veprojmë. Nëse Komisioni është kompetent për ta zgjedhur këtë Këshill atëherë është përgjegjësi e Komisionit që të kërkoj raporte të punës dhe raporte financiar nga Këshilli i kaluar, të bëhen shqyrtimet dhe të shihet nëse ka keqpërdorime sepse për gjëra të tilla duhet të diskutohet më gjatë dhe të propozohen masa.

Shpejtim Bulliqi, tha se pavarësisht procedurave se nga kanë ardhur këta kandidatë, e kemi një listë e cila është me një numër të rëndësishëm të njerëzve, të gjithë kanë një bagazh në profile të caktuara dhe ka mundësi të zgjidhjes brenda kësaj liste.

Salih Morina, tha se kemi një numër të mjaftueshëm të kandidatëve, do të ishte mirë që sot të bëjmë përzgjedhjen sepse është vonuar shumë formimi i këtij Këshilli dhe nëse vazhdon mos funksionimi i tij do të dëmtohet shumë pasuria e trashëgimisë kulturore. Ai tha se sa i përket raporteve të Këshillit të Trashëgimisë Kulturore, Këshilli çdo vit e sjell raportin në Kuvendin e Kosovës dhe i përgjigjet Kuvendit.

Shukrije Bytyqi, tha se kemi ngecje për shkak të ligjeve por për hirë të rëndësisë së këtij Këshilli duhet të vazhdojmë me procedurat e përzgjedhjes. Ajo theksoi se duhet ti kontrollojmë raportet e vitit të kaluar dhe ti shqyrtojmë që në të ardhmën të jemi më eficient dhe të mos kemi lëshime, si te shpenzimet dhe te mënyra e identifikimit të trashëgimive kulturore.

Mufera Sinik, tha ne duhet të vazhdojmë me përzgjedhjen e kandidatëve, kurse raportin vjetor të punës së Këshillit do ta shqyrtojmë sipas afateve kohore.

Bekim Haxhiu, tha se ka vërejtje sa i përketë dokumentacionit, disa nuk e kanë precizuar se cilit nacionalitet i përketin dhe disa i kanë dërguar CV-të në gjuhën angleze, aplikimi do të duhet të ishte në gjuhën shqipe dhe në gjuhën e nacionalitetit të cilit i përketin dhe theksoi se ne si Komision duhet të procedojmë në mënyrë serioze dhe të përzgjedhim njerëz kompetent të cilët e meritojnë.

Shpejtim Bulliqi, tha se më problematike është çështja e dokumentacionit të kandidatit Filko Jovanović i cili përgaditjen profesionale e ka në Mitrovicën e veriut, pasi që këto Universitete nuk janë të akredituara dhe nuk punojnë me sistemin e arsimit të Kosovës. Propozoi që brenda këtij Këshilli të mos ketë kandidatë të të njëjtit profesion por të ketë të profesioneve të ndryshme dhe që secili kandidatë të mund të jap kontributin e tij brenda Këshillit.

Nait Hasani, propozoi që të vazhdoj procedura e përzgjedhjes së anëtarëve të këtij Këshilli dhe të shkoi në seancë sepse prej 2010 nuk e kemi këtë Këshill dhe për pesë (5) vite ka konsumuar buxhetin e Kosovës.

Komisioni pasi shqyrtoi listën e kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore, vendosi që Kuvendit t'ia paraqet këtë :

R e k o m a n d i m

I Rekomandohet Kuvendit të Kosovës të bëjë emërimin e shtatë (7) anëtarëve të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore.

1. Shafi Gashi – shqiptar,
2. Florim Isufi – shqiptar,
3. Ariete Miftari – shqiptare,
4. Doruntinë Matoshi – shqiptare,
5. Visar Haxhibeqiri – shqiptar,
6. Bego Kululleri – turk,
7. Filjko Jovanovic – serb.

4. Shqyrtimi në Parim i Projektligjit për Provimin e Maturës Shtetërore

Nait Hasani, tha se Projektligji për Provimin e Maturës Shtetërore, ka mangësi, lidhur me këtë do të organizojmë takim me Ministrin me qëllimi të sqarimit të mëtejshëm. Ai theksoi se në projektligj ceken dy afate, nëse ky test është i arritshmërisë atëherë pse të jenë dy afate, pastaj përmbajtja e provimit është jo adekuate dhe digjitalizimi i provimit të maturës duhet të rregullohet me ligj jo me akte nënligjore.

Teuta Haxhiu, tha se ky projektligj ka disa dallime nga propozimi i projektligjit të mandatit të kaluar dhe e përkrahë këtë projektligj në parim. Ajo theksoi se duhet të fillojmë me punën, ti ndajmë grupet punuese që të mos vonohemi më shumë.

Salih Morina, tha se duhet ta votojmë në parim këtë projektligj për arsye se çdo shtyrje mund ti tejkalojë afatet e mbajtjes së provimit të maturës dhe pastaj ta ftojme Ministrin dhe të kemi dëgjime publike për këtë çështje.

Shpejtim Bulliqi, tha se ky projektligj ka lëshime të mëdha, është i punuar me shumë gabime, por për shkak të kohës duhet ta procedojmë, në mënyrë që të mos jemi ne si Komision pengesë dhe pastaj ta shqyrtojmë bashkarisht me ministrin.

Ismajl Kurteshi, tha se ky projektligj është shumë i rëndësishëm dhe duhet të trajtohet siç e meriton, në këtë projektligj ka të meta serioze të cilat duhet të evidentohen. Ai propozoi që të intensifikohet puna dhe të mbahen më shpesh mbledhje dhe në Kuvend ta dërgojmë me korigjimet e duhura ose projektligji mund të vonohet për këtë afat, e përgjegjësinë ta marrë Ministria e cila do të duhej ta sillte projektligjin në shkurt. Ai theksoi se përmes këtij projektligji sikurse edhe shumë ligjeve të tjera po krijohet mundësia e lënjes së zbraztirave ligjore të cilat mund të keqpërdoren.

Bekim Haxhiu, tha se pajtohem që në parim ta procedojmë projektligjin edhe pse ka mangësi, si te neni 17, vlerësimi për tu regjistruar në Fakultet nuk është i drejtë sepse vlerësohet më shumë provimi i maturës se sa 4 vitet e shkollës së mesme.

Shukrije Bytyqi, tha se është mirë që provimi ka kaluar nga i kalueshmërisë në të arritshmërisë por duhet të kemi një vlerësim real të gjendjes në shkollat e arsimit parauniversitar, ajo theksoi se projektligjin duhet ta procedojmë në parim edhe pse ka lëshime dhe gabime teknike.

Mufera Sinik, tha se pajtohem që ky projektligj të miratohet në parim dhe pastaj të ftohet Ministri për diskutim sepse ka vërejtje.

Nait Hasani, tha se sipas Rregullores së Kuvendit gjatë fazës së shqyrtimit do të kemi mundësi të bëjmë plotësimin dhe ndryshimin në projektligj.

Pas diskutimeve Komisioni njëzëri nxori këtë

Përfundim

Miratohet në parim Projektligji Nr.05/L-18 për Provimin e Maturës Shtetërore.

Komisioni, Kuvendit ia paraqet këtë

Rekomandim

Të miratohet në parim, Projektligji Nr.05/L-18 për Provimin e Maturës Shtetërore.

5. Të ndryshme

Bekim Haxhiu, tha se do të ishte mirë që vendimet që kemi marrë për monitorimin e zbatimit të Ligjeve të fillojmë me monitorimin e Ligjeve para se ato të vijnë në Kuvend.

Mbledhja përfundoi në orën 12:00.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit

Nait Hasani